



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 02, datë 02.04.2024

P Ë R

**NDRYSHIMIN E VENDIMIT NR. 02, DATË 28.07.2020 TË KËSHILLIT
KOMBËTAR TË TERRITORIT "PËR SHPALLJEN E ZONAVE ME PËRPARËSI
ZHVILLIMIN E TURIZMIT DETAR NË TERRITORIN E REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE MIRATIMIN E HARTËS SË AKTIVITETEVE NË KËTO ZONA**

Në mbështetje të neneve 7, 9, 10 dhe 16 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, të Ligjit Nr. 93/2015 "Për Turizmin", i ndryshuar, Ligjit Nr. 43/2020 "Për aktivitetet e turizmit detar", të Vendimit Nr. 686, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", të ndryshuar, të Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit", i ndryshuar, Vendimit të KKT-së Nr.2, datë 14.06.2016 "Për miratimin e Planit të Integruar Ndërsektorial për Brezin Bregdetar", Vendimit të KKT-së Nr.1, datë 26.07.2018 "Për Shpalljen e Zonave me Përparësi Zhvillimin e Turizmit në Territorin e Republikës së Shqipërisë", me propozim të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, Këshilli Kombëtar i Territorit,

V E N D O S I:

1. Në Vendimin Nr. 02, datë 28.07.2020 të Këshillit Kombëtar të Territorit "Për shpalljen e zonave me përparësi zhvillimin e turizmit detar në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe miratimin e hartës së aktiviteteve në këto zona" bëhen këto shtesa:
 - a. Në pikën 1, fjalët "... 60 zonave të interesit ..." zëvendësohen me "... zonave të interesit , të listuara si më poshtë ...";
 - b. Në pikën 1, pas pikës 1.60, shtohen pikat si më poshtë:
 - 1.61 Liqeni i Pogradecit;
 - 1.62 Lumi i Shalës;
 - 1.63 Liqeni i Shkodres;
 - 1.64 Lumi i Bunës;
 - 1.65 Liqeni i Komanit;





- 1.66 Liqeni i Belshit;
- 1.67 Liqeni i Marinës;
- 1.68 Liqeni i Seferanit;
- 1.69 Liqeni i Merhojës;
- 1.70 Liqeni i Çestijes;
- 1.71 Lumi i Osumit, itinerari Vodicë – Berat dhe Kanioni i Lumit Osum, itinerari 16 km nga fshati Hambull deri në Çorovodë;
- 1.72 Lumi i Vjosës, itinerari Çarshovë – Përmet dhe itinerari 13 km, Gryka e Këlcyrës;
- 1.73 Gryka e Devollit;
- 1.74 Kanioni i Valbonës;
- 1.75 Lumi i Drinit të Zi.

c. Në dokumentacionin e përmendur në pikën 2, të bëhen ndryshime si me poshtë:

- i. Shfuqizohet Harta e aktiviteteve të turizmit detar bashkëlidhur Vendimit Nr. 02, datë 28.07.2020 të Këshillit Kombëtar të Territorit “Për shpalljen e zonave me përparësi zhvillimin e turizmit detar në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe miratimin e hartës së aktiviteteve në këto zona”
- ii. Miratohet Harta e përditesuar e aktiviteteve të turizmit detar sipas dokumentit bashkëlidhur këtij Vendimi.
- iii. Tek materialet shoqërues të hartës së aktiviteteve të turizmit detar të bëhen ndryshime si me poshtë:
 - a. Ndryshohen pasaportat e zonave të listuara më poshtë:
 - Rana e Hedhun;
 - Shëngjin-Veri;
 - Shëngjin;
 - Kune-Vain;
 - Kepi i Rodonit;
 - Gjiri i Lalzit;
 - Rrushkull;
 - Jube-Sukth;
 - Porto Romano;
 - Currilat;
 - Kodrat e Karpenit;
 - Spille;
 - Laguna e Karavastasë;
 - Divjakë;
 - Radhimë;
 - Orikum;
 - Pashaliman;
 - Karaburun;
 - Gjipe;
 - Jal;
 - Kakome;
 - Gji 1;



MINISTRAT

- Gji 2;
- Gji 3;
- Manastir-Ksamil;
- Ksamil;
- Kepi i Skalës.

b. Shtohen pasaportat e zonave të listuara më poshtë:

2. Liqeni i Pogradecit;
3. Lumi i Shalës;
4. Liqeni i Shkodres;
5. Lumi i Bunës;
6. Liqeni i Komanit;
7. Liqeni i Belshit;
8. Liqeni i Marinës;
9. Liqeni i Seferanit;
10. Liqeni i Merhojës;
11. Liqeni i Çestijes;
12. Lumi i Osumit, itinerari Vodicë – Berat dhe Kanioni i Lumit Osum, itinerari 16 km nga fshati Hambull deri në Çorovodë;
13. Lumi i Vjosës, itinerari Çarshovë – Përmet dhe itinerari 13 km, Gryka e Këlcyrës;
14. Gryka e Devollit;
15. Kanioni i Valbonës;
16. Lumi i Drinit të Zi.

2. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Bregdetit dhe gjitha Autoritetet e Planifikimit dhe Zhvillimit të territorit që përfshihen në këto zona për zbatimin e këtij vendimi.

3. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit.



MINISTËR I LINJËS

MIRELA KUMBARO FURXHI

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 28/05 / 2024